



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 835 Prot.

Tiranë, më 10.06.2025

REKOMANDIM

Nr. 26, datë 10.06.2025

PËR KONTROLLUESIN LABORATORI MJEKËSOR “LUARMED”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit Laboratori mjekësor “*LuarMed*”, Tiranë (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 45, datë 05.03.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt M02303007E dhe ushtron aktivitet si: “*Aktivitete diagnostifikues mjekësor. Vizita dhe konsulta mjekësore të specialiteteve të ndryshme në fushën e mjekësisë, diagnostifikimit, mjekim, urgjenca dhe shërbime të tjera mjekësore etj.,*”

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “pacientë”; “staf administrativ”; “mjekë”, “infirmierë” etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, përmes të cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve ku ushtron veprimtarinë e tij, me qëllim të mbrojtjes së pronës dhe sigurinë e kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rregullores “*Procedura standarde për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave*”, të vendosur në dispozicion, konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi në pikën 6 të Rregullores “*Politika e ruajtjes së të dhënave*” ka parashikuar afate për ruajtjen e imazheve maksimumi për 30 ditë, por nga verifikimi i kamerave konstatohet se ato ruhen për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe pikës 4/a, të Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemit e video survejimit*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe” e “video”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video survejimit duhet të ruhen për një periudhë deri në dy muaj, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

3. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://www.luarmed.al>. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të

rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

4. Kontrolluesi aplikon formularin “tip” të kërkesës për testim “*Gjenetika molekulare*” nëpërmjet të cilit mbledh të dhëna për pacientin si, “*emër/mbiemër*”; “*origjina gjeografike*”; “*gjinia*”; “*adresa*”. Rezulton se, në formularin “tip” nuk ka të parashikuar asnjë rubrikë në mënyrë që të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

5. Konstatohet se, Kontrolluesi ka lidhur kontratë shërbimi me palë të treta, konkretisht “*Firdeus Security*” sh.a, datë 01.02.2024 me objekt montimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të video-survejitimit (CCTV) që disponojnë.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka lidhur kontratë, datë 03.01.2025 për “*Mirëmbajtjen e programit kompjuterik “e-doctors” për menaxhimin e të dhënave*”; me objekt mirëmbajtje teknike e programit kompjuterik *e-doctors*, ku është në cilësinë e autoritetit kontraktor (kontrollues) dhe “ ” p.f në cilësinë e kontraktuesit (përpunues).

Sistemi “*e-doctors*” popullohet me kategoritë e të dhënave të pacientëve përkatësisht: gjeneralitete të pacientëve, si dhe analizat specifike. Fushat përkatëse me kategoritë e të dhënave, plotësohen përmes hedhjes manuale të të dhënave nga stafi i Kontrolluesit.

Nga verifikimi i përmbajtjes së kontratave konstatohet se, nuk ka parashikime të detyrimeve midis Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të shërbimeve, sa i përket kushteve teknike dhe organizative dhe masave të sigurisë, të detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e Përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të

këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me nenin 26 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

6. Kontrolluesi disponon rregullore “*Procedura standarde për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave*”, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, përmbajta e rregullores është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Rregullorja, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Konstatohet se, të dhënat sensitive (të lidhura me shëndetin) të subjekteve të të dhënave që përpunohen nga Kontrolluesi, nuk identifikohen në rregullore, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë parashikuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, në të të parashikohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

7. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit si dhe të Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”, (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”).

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se në kontratat individuale të punës, parashikohen dispozita lidhur me konfidencialitetin, konkretisht në nenin 10, pikat 5 dhe 6, “*Detyrimi i bensikërisë, ekskluzivitetit dhe konfidencialitetit*”. Megjithatë, në pikën 6 të Vendimit nr. 6, parashikohet se, kontrolluesi detyrohet, për çdo punonjës, që kryesisht përpunon të dhëna sensitive të nënshkruajë “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, sipas modelit të këtij vendimi.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

8. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 29.04.2025, ka parashtruar pretendimet me shkrim nr. 05 prot., datë 23.04.2025, administruar me tonën nr. 835/5 prot., datë 25.04.2025, si dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 28, 30, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura për subjektet e të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, në përputhje me dispozitat e nenit 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbaj evidenca për shkatërrimin;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://www.luarmed.al>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, duke përfshirë në formularin “tip” të kërkesës për testim “*Gjenetika molekulare*”, një rubrikë të posaçme, në mënyrë që të informojë subjektet e të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të përfshijë në rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 30 të Ligjit, të aplikojnë “*Deklaratën e Konfidencialitetit*” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMIS) për mbrojtjen e të dhënave personale;

9. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
10. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
- (i) menjëherë, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 7 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 5 dhe 6 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 8 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

11. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
12. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 10.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi